

**UNIVERSITETI I PRISHTINËS**  
**“HASAN PRISHTINA”**  
**FAKULTETI I KULTURËS FIZIKE DHE I SPORTIT**



**PUNIM DIPLOME – MASTER**

**TEMA:**

**NDIKIMI I ELEMENTEVE TEKNIKO - TAKTIKE NË SUKSESIN E LOJËS SË  
FUTBOLLIT NË KAMPIONATIN BOTËROR BRAZILI 2014**

**MENTORI:**  
Prof.Asoc. Dr. Bylbyl Sokoli

**KANDIDATI:**  
Dardan Llagjaj

Prishtinë, Mars, 2019

## PËRMBAJTJA

|   |           |
|---|-----------|
| 1. HYRJE .....  | 3         |
| 2. HULUMTIMET E GJERTANISHME .....  | 6         |
| 3. QËLLIMI I PUNIMIT .....  | 9         |
| 4. HIPOTEZAT THEMELORE .....  | 10        |
| 4. METODOLOGJIA E PUNËS .....   | 11        |
| 4.1. MOSTRA E EKIPEVE .....   | 11        |
| 4.2. PARAMETRAT E TEKNIKËS SË LOJËS .....   | 12        |
| 4.3. REZULTATET E PARAMETRAVE TEKNIKO-TAKTIK TË NDESHJEVE.....  | 13        |
| 4.3. METODAT E PËRPUNIMIT TË REZULTATEVE.....   | 20        |
| 5. INTERPRETIMI I REZULTATEVE DHE DISKUTIMI.....  | 21        |
| 5.1. TREGUESIT THEMELOR STATISTIKOR.....  | 21        |
| <b>5.1.1 Parametrat themelor statistikor dhe të shpërndarjes të elementeve tekniko-taktike te ekipi i Argjentinës .....</b>                   | <b>21</b> |
| <b>5.1.2 Parametrat themelor statistikor dhe të shpërndarjes të elementeve tekniko-taktike te ekipi i Gjermanisë .....</b>                    | <b>21</b> |
| <b>5.1.3 Parametrat themelor statistikor dhe të shpërndarjes të elementeve tekniko-taktike te ekipet humbëse në grupin e Argjentinës.....</b> | <b>33</b> |
| <b>5.1.4 Parametrat themelor statistikor dhe të shpërndarjes të elementeve tekniko-taktike te ekipet humbëse në grupin e Gjermanisë.....</b>  | <b>21</b> |
| 5.2. MATRICA E INTERKORRELACIONIT TË PARAMETRAVE TEKNIKE .....  | 45        |
| 5.3. DALLIMI NË MES GRUPIT TË EKIPEVE NË PARAMETRAT TEKNIKO-TAKTIK .....  | 46        |
| 5.4. ANALIZA REGRESIVE .....  | 53        |
| 5.5. VËRTETIMI I HIPOTEZAVE .....   | 55        |
| 6. PËRFUNDIMI .....   | 56        |
| 8. LITERATURA .....   | 58        |

# 1. HYRJE

Futboli si sport numërohet në grupin e sporteve kolektive, kurse sipas lëvizjeve bie në grupin e sporteve shumë strukturale të aktiviteteve komplekse, i cili dallohet me lëvizje ciklike dhe aciklike. Është sporti më i popullarizuar në botë, kjo vjen nga prania e dinamikës, emocionalitetit dhe atraktivitetit si dhe shumë lëvizjeve të përbëra tekniko-taktike të cilët ndodhin në të gjitha pjesët e fushës.

Investimi i shumave të mëdha të parave ka sjellur paralelisht, deri te kërkesa për rritjen e aftësive psiko-fizike të futbollistëve dhe zhvillimin adekuat të programeve që sigurojnë sukses në lojën e futbollit. Tri dekadat e fundit me komercializimin e madh të futbollit, ka kushtëzuar ndryshime të mëdha jo vetëm në programimin dhe metodologjinë e trajnigut por edhe në kalendarin e garave .

Loja e futbollit në kohën e sotme ka ndryshuar shumë, meqë tani rezultatet nuk arrihen aty për aty por kërkohet një punë e gjatë dhe sistematike që skuadra të ketë sukses të lakmueshëm.

Analizimi i ndeshjeve në të kaluarën është bërë në mënyrë të thjeshtë, kurse tani ka programe të ndryshme që mundësojnë analizimin e ndeshjeve në mënyrë kompjuterike. Teknologjitë e reja ofrojnë gjithnjë e më tepër sisteme, aparate, pajisje dhe metoda më të cilat mundësohet aplikimi i gjerë i njohurive bashkëkohore shkencore në praktikën e përditshme. Teknologjitë e reja mundësojnë bazë metodologjike sistematiko-doktrinare, materialo-teknike dhe teknologjike për avancimin e procesit stërvitor dhe efikasitetin e procesit të këndelljes. Rëndësia e teknologjisë së re për avancimin e futbollit manifestohet në shumë drejtime. Analiza e lojërave në punim është bërë nga një program kompjuterik turk (e-spor., e-analisis)<sup>1</sup>.

---

<sup>1</sup> Përpos programit të përcjelljes dhe analizës së lojës së futbollit **“Castrol Performance index”** ndërsa promotor i këtij programi ka qenë treneri i ekipit të Arsenalit nga Anglia Arsen Wenger, programi i analizës së lojës në Turqi bëhet sipas programit “e-spor., e-analisis”.

Ne Turqi të gjitha ligat turke, liga e parë, liga e dytë dhe liga e tretë që disa vite përdorin këtë program për analizimin e lojërave të kampionatit turk gjatë gjithë sezonit. Analizimi i lojës në mënyrë kompjuterike i mundëson trajnerit që të kenë informata më të mëdha për ekipin e vet, pra mundëson që trajneri të ketë një fotografi më të qartë për ekipin e vet.

Ky program kompjuterik gjatë një ndeshje regjistron, të gjitha pasimet, goditjet në portë, driblingjet, ndërprerjet, ndërhyrjet, ofsajdët, mundëson regjistrimin e të gjitha sulmeve të çdo ekipi, përqindjen e topit gjatë ndeshjes, për çdo lojtar regjistron çdo pasim, çdo ndërhyrje të suksesshme, çdo humbje të topit për çdo lojtar.

Analiza e lojës ju shërben klubeve apo trajnerëve, për shikim të gjitha situatave të ndryshme që kanë ndodh gjatë një loje. Çka analizohet, analizohet a është arritur qëllimi në atë lojë, a është fituar loja apo është humbur, ku janë bërë gabimet e ekipit, në cilën pjesë të fushës, humbjet e topit, apo në cilën pjesë të fushës kundërshtari është më i rrezikshëm, në cilin element është më i fort kundërshtari, apo cilin element e ka defekt kundërshtari, çfarë sistemi të lojës luanë. Analizën e lojës trajneri e bënë çdo herë një ditë pas ndeshjes, pra analizohet kontributi i ekipes.

Asnjëherë nuk duhet lojtari të kritikohet si person por, të kritikohet kontributi i tij gjatë lojës, analizohen të gjitha linjat dhe pozitat e ekipit gjatë asaj ndeshje. Dhe në bazë të analizave trajneri në stërvitje i ushtron situatat e ndryshme, që të behet eliminimi i atyre gabimeve që janë paraqitur gjatë ndeshjeve të kaluara.

Analizohet loja në ekip dhe loja e ekipit kundërshtar, trajneri më shumë analizon këto elemente, dhe në cilin moment të lojës po paraqitet problemi, cilat linja janë të përfshirë në problem, në cilën pjesë të fushës paraqitet problemi, pse problemi paraqitet, cilët principe janë thyer. Trajneri duhet ti identifikoj anët e forta dhe të dobëta te ekipit të vet dha anët e dobëta dhe te forta të ekipit kundërshtar, dhe duhet të dijë si ti shfrytëzoj anët e forta të ekipit të vetë dhe anët e dobëta të ekipit kundërshtar. Është vështirë që saktësisht ti definojnë faktorët të cilët sjellin deri te fitorja ose humbja për shkak të kompleksitetit të lojës së futbollit. Mirëpo, të dallohen format e ndryshme të aktiviteteve të lojtarëve në fushë dhe të grumbullohen të dhëna të shumta mbi sjelljet e lojtarëve në lojë mund të na mundësohet të vërtetojmë faktorët të cilët mundësojnë suksesin në lojë. Metoda e dytë e dobishme për identifikimin e faktorëve vendimtar për suksesin

përfundimtar sportiv është vlerësimi i ekzekutimit kualitativ dhe kuantitativ të elementeve tekniko-taktike të lojës të ekipeve fituese dhe humbëse në duelin e drejt për drejt.

Gjatë lojës numri më i madhë i aftësive motorike në proceset e aktiviteteve komplekse kineziologjike, në rastin konkret në lojën e futbollit, e sidomos gjatë lojës, më së tepërmi varën nga procesi i pranimit, bartjes, mbajtjes dhe përpunimit si dhe përcjelljes me rrugë eferente deri te efektorët. Lidhmëria e këtyre elementeve si dhe elementeve tjera antropologjike kërkon nga njeriu që ai të trajtohet si sistem kibernetik. Që të mund të vlerësohet dhe matet ndonjë aksion i njeriut në hapësirën motorike dhe lidhmërin e saj me karakteristikat tjera antropologjike është e domosdoshme që këtë strukturë që ta identifikojmë.

Është e natyrës që variablat situaciono-motorike së bashku me aftësitë teknike dhe karakteristikat e elementeve taktike si dhe veçorit konative si dhe ato sociale tek futbollistët duhet të jenë në ndonjë korelacion të caktuar. Niveli dhe vlerat e këtyre raporteve dhe lidhjeve gjerë më tani nuk janë hulumtuar në nivelin e kënaqshëm.

Që të arrihet deri te sukcesi gjatë zhvillimit të garave të ndryshme në nivele të ndryshme të zhvillimit të tyre e sidomos: kampionati evropian dhe ai botëror, kupa e UEFA-s, e sidomos liga e kampionëve është e domosdoshme përgaditja sa më e mirë e ekipeve në aspektin kondicional.

Loja e futbollit e cila është një ndër lojërat më të përhapura dhe më të popullarizuara sot në botë, ku përveç aspektit shëndetësor që ka, ka edhe anën tjetër fitimprurëse materiale. Futboli bënë pjesë në aktivitetet kineziologjike polistrukturale komplekse sukcesi i së cilës varet nga shumë faktorë. Këta faktor duhet shikuar në aspektin antropologjik, nga aspekti se si sportisti në rastin konkret futbollisti, sikur çdo njeri i rëndomtë është qenie bio-psiko-sociale. Kërkesat në futbollin bashkëkohor kërkojnë nga futbollisti që gjatë garave ta jep maksimumin e vet që ndoshta nganjëherë për shkak të interesave<sup>2</sup> të menaxherëve sportiv harrohet aspekti human i futbollistit.

---

<sup>2</sup> Interesi definohet si tendencë që të kryhet aktiviteti i caktuar sportive sipas qëllimeve të caktuar dhe aktiviteteve.

## 2. HULUMTIMET E GJERTANISHME

Hulumtimet e gjertanishme të cilët janë bërë mbi analizimin e ekipeve dhe kombëtareve janë bërë nga autor: Swarc, A. ( 2004 ) Efikasiteti i ekipeve Braziliene dhe Gjermane gjatë kampionatit botëror të 17-të. Yamaka, K dhe dr. An ( 1999 ) analizimi i lojërave të kombëtares Japoneze gjatë kampionatit botëror në vitin 1998. Gazeta e Shkencave Sportive. Zubilaga , A ., Garasper, G. ( 2007 ) Analiza e finales së ligës së kampioneve të mbajtur në vitin 2005 – 06 : Scoulding, A., James, N., Taylor, J. ( 2004 ) që kalojnë në kupën botërore të 200 të futbollit, Angelov, Kërstev, \Koen në periudhën 1973 - 1974 deri me 1977 – 78, kanë kryer hulumtimin në 159 ndeshje të ligës së parë të Bullgarisë, me qëllim të vërtetimit të lidhshmërisë të goditjeve në port nga afër, largësia e mesme dhe nga largësia me rezultatin përfundimtar. Nga rezultatet e fituara autorët japin këto përfundime : goditjet nga afër në portë kanë lidhshmëri të madhe me rezultatin e ndeshjes, goditjet nga largësia e mesme gjithashtu kanë lidhshmëri të lartë me rezultatin e ndeshjes, kurse goditjet nga largësia kanë lidhshmëri negative me rezultatin e ndeshjes.

**Bozhenko (1978)** ka kryer hulumtime në 60 ekipe kulminante, me qëllim të vërtetimit të përfshirjes së përqindjes të elementeve tekniko – taktike në lojën e futbollit. Në hulumtim kanë qenë të përfshirë këto elemente tekniko – taktike: pasimet e shkurta, pasimet e mesme, pasimet e gjata, udhëheqja e shpejt e topit dhe driblingjet, lufta për top në tok, lufta për top në ajër, goditja në portë pranimi i topit në prani të lojtarit kundërshtar, numri i faulleve. Nga rezultatet e fituara autori ka vërtetuar përfshirjen në përqindje të këtyre elementeve në lojën e futbollit: Pasimet i shkurtra dhe të mesëm janë përfshirë me 50 %, Pasimi i shkurtër dhe i mesëm janë përfshirë me 50%, pasimet e gjata me 10 %. Lufta për top në tokë me 10 %, udhëheqja e topit dhe driblingjet 10 %, lufta për top në ajër, goditjet në portë, pranimi i topit në prani të kundërshtarit dhe faullat me 12 %.

**Wrcos (1987)** ka kryer hulumtime në 38 ekipe të kampionatit botëror në Argentinë, qëllimi i këtij hulumtimi ka qenë që të vërtetohet efikasiteti i goditjeve në portë me këmbë dhe kokë te ekipet e Evropës dhe Amerikës jugore. Sipas këtij hulumtimi ekipet evropiane kanë treguar këto rezultate: Numri më i madh i golave janë shënuar në aksion deri me

4 kontakte në sulm. Goditjet më të mëdha në portë kanë mundësuar aksione 2 – 3 kontakte të topit në sulm, afro 30 % e aksioneve në portë kanë mbaruar me goditje të topit me kokë, efikasitet të madh kanë pasur goditjet nga largësia 16 metër.

**Soryzinski dhe Norek (1982)** kanë bërë analizë të kampionatit botëror në futboll në Spanjë. Qëllimi i këtij hulumtimi ishte të shihet në cilën pjesë të lojës bien më shumë gola. Për këtë qëllim kohëzgjatja e lojës ishte ndarë në 6 faza, çdo fazë kishte 15 minuta, nga rezultatet e fituara del se më shumë gola janë shënuar në fazën e 4, 5, dhe 6 të lojës, çka do të thotë në pjesën e dytë të lojës.

**Ksionda (1981)** ka bërë hulumtim në kampionatin Spanjoll, ku autori ka pasur qëllim të hulumtoj përfshirjen e elementeve tekniko – taktike dhe koeficientin e efikasitetit. Si koeficient të efikasitetit ka marrë: numrin e aksioneve ofanzive në raport me topat e humbur. Në bazë të rezultateve të fituara autori ka arritur në përfundim se: në një ndeshje mesatarisht duhet të kryhen 15 goditje në portë; Në një ndeshje mesatarisht duhen të kryhen 45 aksione ofanzive; Në një ndeshje duhet të humben mesatarisht 40 topa. Konstatim tjetër është se nëse luhet me kundërshtar më të dobët se vet ekipi duhet të bëhen më shumë aksione ofanzive gjatë ndeshjes, kurse kur luhet me kundërshtarë për afërsisht me kualitete të njëjta duhet më shumë të drejtohem në taktikën racionale defanzive.

**Kapllanbegu (2011)** Me qëllim të përcaktimit të treguesve tekniko-taktik të cilat janë pjesë përbërëse të lojës së futbollit dhe se varësisht prej shkallës së përvetësimit dhe të realizimit gjatë lojës varet edhe rezultati përfundimtar i lojës ku janë aplikuar 14 variabla tekniko-taktike gjatë lojërave të ekipeve fituese dhe humbëse të ligës së kampionëve gjatë vitit kalendarik 2009/10. Popullata nga e cila është nxjerrë mostra për analizë në këtë punim është definuar si popullata, e ekipeve pjesëmarrës gjatë ndeshjeve të grupeve C dhe D të ligës së kampionëve në futboll saktësisht ndeshjeve të Milanit, Realit, Interit dhe Barcelonës. Për qëllimet e këtij punimi janë përfshirë edhe ekipet humbëse me qëllim të krahasimit të rezultateve. Rezultatet e variablave të aplikuara kanë qenë rezultat i përcjelljes së elementeve tekniko-taktike me anën e kamerave dhe përpunimit të tyre me anë të programeve kompjuterike të 17 ndeshjeve. Përpunimi i të dhënave tregon se:

1. Suksessi në lojë e futbollit varet nga realizimi i suksesshëm i elementeve tekniko-taktike të lojës duke filluar nga përqindja e kohës së posedimit të topit e deri te numri i sulmeve gjatë lojës.
2. Matrica e interkorelacionit tregon se në përqindjen e kohës së posedimit të topit gjatë lojës më së tepërmi ndikojnë pasimet e shkurta pozitive ose të suksesshme (PSHP) dhe numri i sulmeve të ekipit (SULE).
3. Izolimi i pesë faktorëve nga variajablat manifeste tekniko-taktike ose situacionale tregojnë për atë se këta faktor të elementeve tekniko-taktike veprojnë ndaras dhe se për këtë duhet kushtuar rëndësi që të inkorporohen në tërësi
4. Rezultatet e fituara vërtetojnë përvojën e njohurive se suksesit në gara në ekipet kulminante më e rëndësishme është shënimi i golit dhe mbajtja e topit me elemente më të thjeshta dhe kontribuuese tekniko-taktike.
5. Për fitore elementet vendimtare janë: pasimet e shkurta pozitive, gjuajtjet e sakta në portë, rivëniet pozitive fundore, përqindja e posedimit të topit dhe numri i sulmeve drejt portës.

**Aliji (2009) në hulumtimin e tij kishte për qëllim** bëj analizimin e ndikimit të disa parametrave tekniko-taktik në suksesin e lojës në futboll tek disa ekipe më të mira të tri kampionateve evropiane edhe atë të: Kampionatit Italian, Gjerman dhe Anglez. Për këtë qëllim mostra për këtë punim është definuar si popullatë e lojtarëve të tri shteteve pjesëmarrëse në kampionatin 2008/09. Parametrat tekniko-taktik të cilat janë nxjerrë nga lojërat që i kanë zhvilluar 13 ekipet e të tri shteteve janë: Posedimi i topit në %, pasimet e shkurta, pasimet e gjata, gjuajtjet në portë, ekzekutimet e topit pas ndërprerjeve dhe sulmet e ekipit. Shënimet ose rezultatet për qëllimet e këtij punimi janë nxjerr nga teknologjia informative sipas programit “ turek e- spor”.Përpunimi i të dhënave tregon se suksesit i ekipit nuk varet vetëm nga kohëzgjatja e posedimit të topit, por, edhe nga elementet tjera tekniko-taktike. Nga elementet tekniko-taktike sipas rezultateve të fituar rrjedh se suksesit i ekipit nuk varet shumë nga numri i pasimeve të ndryshme, por nga preciziteti i tyre si dhe preciziteti i ekzekutimeve të topit pas ndërprerjeve. Gjuajtjet pozitive dhe negative në drejtim të portës në mënyrë direkte ndikojnë në rezultatin përfundimtar. Sipas rezultateve të fituara në organizimin e sulmeve të suksesshme më së shumti ndikojnë rivëniet e suksesshme nga vija anësore, autat pozitiv (AUTP), dhe gjuajtjet e pasuksesshme drejt portës, gjuajtjet negative drejt portës (GJPN



### 3. QËLLIMI I PUNIMIT

Sikurse në të gjitha lojërat ekipore ashtu edhe në lojën e futbollit në arritjen e suksesit ndikojnë shumë faktorë ndër më të rëndësishmit janë: veprimi tekniko-taktike, aftësitë motorike, funksionale, kongnitive, karakteristikat antropometrike, vetit konative e tj. Futbollistët në lojën e futbollit, bashkëpunimin ndërmjet veti, ballafaqimin me kundërshtarin e arrijnë nëpërmjet të manipulimit të topit. Raporti i tillë ndaj topit nuk guxon të kuptohet si mjet mekanik i ndërmjetësimit në mes lojtarëve. Kjo është shprehje e një aktiviteti të caktuar dhe kreativ për arritjen e qëllimit të dëshiruar, a para së gjithash është shprehje e mendimit kolektiv, për arritjen e qëllimit të caktuar taktik. Kryerje e lëvizjeve kreative me top dhe pas topit e bëjnë fizionominë e lojës së futbollit dhe janë të karakterizuara si veprime taktiko-teknike. Nëpërmjet hulumtimeve shkencore zbulohen faktorët të cilët në mënyrë direkte dhe indirekte ndikojnë në arritjen e rezultateve të mira.

Vlerësimet subjektive të një trajneri apo grupi ekspertësh nuk mund të nxjerrin një përfundim të sakët mbi angazhimin real të lojtarëve në fushën e futbollit gjatë ose pas lojës. Në një lojë të caktuar është e nevojshme që vlerësimet mbi kontributin e lojtarëve gjatë një ndeshje futbolistike të mbështeten në teknologjinë informative bashkohore.

Qëllimi i këtij punimi është që të vërtetohet dallimi në disa elemente tekniko-taktike në mes dy ekipeve finaliste në futboll në Kampionatin Botëror në futboll Brazili 2014. Gjithashtu qëllimi sekondar do të jetë analizimi i ndikimit të disa parametrave tekniko-taktik në suksesin e lojës në futboll, sidomos ndikimi i disa parametrave tekniko-taktik te ekipet fituese (Gjermania dhe Argjentina).

## 4. HIPOTEZAT THEMELORE

Në bazë të lëmisë dhe problemit të hulumtimit dhe në përputhje me qëllimin dhe metodat statistikore për përpunimin e rezultateve formulohen dhe parashtrohen këto hipoteza në mënyrë alternative:

H1 – Ekipi fitues i kampionatit Botëror Brazili 2014 do të ketë kohë të posedimit të topit më të gjatë se sa ekipi humbës në të gjitha ndeshjet.

H2 – Ekipi fitues i kampionatit Botëror Brazili 2014 do të ketë pasime të shkurtra pozitive më tepër në të gjitha pjesët e fushës krahasuar me ekipin humbës në të gjitha ndeshjet.

H3 – Ekipi fitues i kampionatit Botëror Brazili 2014 do të ketë pasime të gjata pozitive më tepër në të gjitha pjesët e fushës krahasuar me ekipin humbës në të gjitha ndeshjet.

H4 – Ekipi fitues i kampionatit Botëror Brazili 2014 do të ketë më tepër gjuajtje pozitive në portë krahasuar me ekipin humbës në të gjitha ndeshjet.

H5 – Ekipi fitues i kampionatit Botëror Brazili 2014 do të ketë rivënie fundore të topit fundor më të mira krahasuar me ekipet humbës në të gjitha ndeshjet.

H6 – Ekipi fituese i kampionatit Botëror Brazili 2014 do të ketë më tepër sulme në drejtim të portës krahasuar me ekipin humbës në të gjitha ndeshjet.

H7 – Ekziston një lidhje e rëndësishme e koeficienteve të korelacionit në mes ndryshoreve teknike të lojës në nivel  $P=0.01$ .

H8 – Rezultatet e numrit të sulmeve të ekipeve si ndryshore kritere dhe parametrave situacional ose ndryshoreve teknike të lojës si ndryshore predikatore, në hapësirën manifeste do të kenë lidhje të rëndësishme statistikore në nivel prej  $P = 0.01$ .

## 4. METODOLOGJIA E PUNËS

### 4.1 MOSTRA E EKIPEVE

Ekipet nga e cila është nxjerrë mostra për analizë në këtë punim është definuar si popullata e lojtarëve të dy ekipeve finalist të Kampionatit Botëror, Brazili 2014, Gjermanisë dhe Argjentinës deri në finale. Ndeshjet të cilat janë përfshirë në këtë hulumtim janë:

| Nr | Ekipi      | Ekipi                  | R    |
|----|------------|------------------------|------|
| 1  | Argjentina | Bosnja dhe Hercegovina | 2:1  |
| 2  | Argjentina | Irani                  | 1:0  |
| 3  | Argjentina | Nigeria                | 3:2  |
| 4  | Argjentina | Belgjika               | 1:0  |
| 5  | Argjentina | Holanda                | 4:2  |
| 6  | Argjentina | Zvicra                 | 1:0  |
| 7  | Gjermania  | Gana                   | 2:2  |
| 8  | Gjermania  | Portugalia             | 4:0  |
| 9  | Gjermania  | SHBA                   | 0 :0 |
| 10 | Gjermania  | Algjeri                | 2:1  |
| 11 | Gjermania  | Franca                 | 1:0  |
| 12 | Gjermania  | Brazili                | 7:1  |
| 13 | Gjermania  | Argjentina             | 1:0  |

## 4.2. PARAMETRAT E TEKNIKËS SË LOJËS

Parametrat e teknikës së lojës në këtë hulumtim, janë bërë nga matjet me anë të programit kompjuterike të 12 variablave, për 13 ndeshjet të Kampionatit Botëror, Brazili 2014. Pas inçizimit të ndeshjeve është bërë përpunimi i këtyre ndeshjeve në program kompjuterik “ turek e- spor”. Në këtë punim janë përfshirë këta parametra teknik të lojës:

|                                |      |
|--------------------------------|------|
| Përçindja e posedimit të topit | PPOT |
| Pasimet e gjata pozitive       | PGJP |
| Pasimet e gjata negative       | PGJN |
| Pasimet e shkurtra pozitive    | PSHP |
| Pasimet e shkurtra negative    | PSHN |
| Gjuajtjet pozitive në portë    | GJPP |
| Gjuajtjet negative në portë    | GJNP |
| Auta – pozitiv                 | AUTP |
| Auta – negativ                 | AUTN |
| Korna                          | KORN |
| Faulla                         | FAUL |
| Sulmet e ekipit                | SULE |

#### 4.3. REZULTATET E PARAMETRAVE TEKNIKO-TAKTIK TË NDESHJEVE

Rezultatet tekniko-taktike të ekipeve janë të paraqitura në tabelat e mëposhtme.

| Ekipet                         | Argjentina 2 | Bosnja dhe Hercegovina 1 |
|--------------------------------|--------------|--------------------------|
| Përqindja e posedimit të topit | 59           | 41                       |
| Pasimet e gjata Pozitiv        | 34           | 29                       |
| Pasimet e gjata Negativ        | 26           | 30                       |
| Pasimet e shkurtra Pozitiv     | 152          | 131                      |
| Pasimet e shkurtra Negativ     | 9            | 15                       |
| Gjuajtjet në portë Pozitiv     | 2            | 6                        |
| Gjuajtjet në portë Negativ     | 12           | 16                       |
| Auta – pozitiv                 | 23           | 16                       |
| Auta – negativ                 | 1            | 2                        |
| Korna                          | 2            | 6                        |
| Faulla                         | 10           | 14                       |
| Sulmet e ekipit                | 87           | 69                       |

| Ekipet                         | Argjentina 1 | Irani 0 |
|--------------------------------|--------------|---------|
| Përqindja e posedimit të topit | 74           | 26      |
| Pasimet e gjata Pozitiv        | 38           | 25      |
| Pasimet e gjata Negativ        | 14           | 21      |
| Pasimet e shkurtra Pozitiv     | 163          | 124     |
| Pasimet e shkurtra Negativ     | 12           | 21      |
| Gjuajtjet në portë Pozitiv     | 4            | 3       |
| Gjuajtjet në portë Negativ     | 21           | 8       |
| Auta – pozitiv                 | 19           | 15      |
| Auta – negativ                 | 0            | 1       |
| Korna                          | 10           | 6       |
| Faulla                         | 7            | 14      |
| Sulmet e ekipit                | 84           | 58      |

| Ekipet                         | Argjentina 3 | Nigeria 2 |
|--------------------------------|--------------|-----------|
| Përqindja e posedimit të topit | 61           | 39        |
| Pasimet e gjata Pozitiv        | 39           | 24        |
| Pasimet e gjata Negativ        | 15           | 20        |
| Pasimet e shkurtra Pozitiv     | 170          | 121       |
| Pasimet e shkurtra Negativ     | 11           | 22        |
| Gjuajtjet në portë Pozitiv     | 13           | 3         |
| Gjuajtjet në portë Negativ     | 18           | 12        |
| Auta – pozitiv                 | 22           | 16        |
| Auta – negativ                 | 0            | 1         |
| Korna                          | 12           | 4         |
| Faulla                         | 5            | 16        |
| Sulmet e ekipit                | 79           | 51        |

| Ekipet                         | Argjentina 1 | Belgjika 0 |
|--------------------------------|--------------|------------|
| Përqindja e posedimit të topit | 47           | 53         |
| Pasimet e gjata Pozitiv        | 34           | 42         |
| Pasimet e gjata Negativ        | 12           | 15         |
| Pasimet e shkurtra Pozitiv     | 150          | 160        |
| Pasimet e shkurtra Negativ     | 12           | 22         |
| Gjuajtjet në portë Pozitiv     | 2            | 1          |
| Gjuajtjet në portë Negativ     | 10           | 10         |
| Auta – pozitiv                 | 23           | 19         |
| Auta – negativ                 | 1            | 1          |
| Korna                          | 4            | 11         |
| Faulla                         | 11           | 14         |
| Sulmet e ekipit                | 71           | 76         |

| Ekipe                          | Argjentina 4 | Belgjika 2 |
|--------------------------------|--------------|------------|
| Përçindja e posedimit të topit | 44           | 56         |
| Pasimet e gjata Pozitiv        | 41           | 39         |
| Pasimet e gjata Negativ        | 9            | 15         |
| Pasimet e shkurtra Pozitiv     | 148          | 151        |
| Pasimet e shkurtra Negativ     | 9            | 15         |
| Gjuajtjet në portë Pozitiv     | 4            | 1          |
| Gjuajtjet në portë Negativ     | 8            | 7          |
| Auta – pozitiv                 | 18           | 23         |
| Auta – negativ                 | 1            | 2          |
| Korna                          | 4            | 4          |
| Faulla                         | 10           | 15         |
| Sulmet e ekipit                | 68           | 73         |

| Ekipe                          | Argjentina 1 | Zvicra 0 |
|--------------------------------|--------------|----------|
| Përçindja e posedimit të topit | 63           | 37       |
| Pasimet e gjata Pozitiv        | 51           | 36       |
| Pasimet e gjata Negativ        | 6            | 14       |
| Pasimet e shkurtra Pozitiv     | 161          | 147      |
| Pasimet e shkurtra Negativ     | 9            | 11       |
| Gjuajtjet në portë Pozitiv     | 8            | 4        |
| Gjuajtjet në portë Negativ     | 29           | 15       |
| Auta – pozitiv                 | 21           | 19       |
| Auta – negativ                 | 0            | 1        |
| Korna                          | 13           | 5        |
| Faulla                         | 18           | 29       |
| Sulmet e ekipit                | 73           | 66       |

| Ekipet                         | Gjermania 2 | Gana 2 |
|--------------------------------|-------------|--------|
| Përqindja e posedimit të topit | 62          | 38     |
| Pasimet e gjata Pozitiv        | 54          | 31     |
| Pasimet e gjata Negativ        | 2           | 15     |
| Pasimet e shkurtra Pozitiv     | 153         | 149    |
| Pasimet e shkurtra Negativ     | 12          | 18     |
| Gjuajtjet në portë Pozitiv     | 4           | 6      |
| Gjuajtjet në portë Negativ     | 18          | 4      |
| Auta – pozitiv                 | 25          | 17     |
| Auta – negativ                 | 0           | 2      |
| Korna                          | 7           | 3      |
| Faulla                         | 11          | 17     |
| Sulmet e ekipit                | 69          | 57     |

| Ekipet                         | Gjermania 4 | Portugalia 0 |
|--------------------------------|-------------|--------------|
| Përqindja e posedimit të topit | 57          | 43           |
| Pasimet e gjata Pozitiv        | 60          | 41           |
| Pasimet e gjata Negativ        | 4           | 11           |
| Pasimet e shkurtra Pozitiv     | 148         | 132          |
| Pasimet e shkurtra Negativ     | 9           | 16           |
| Gjuajtjet në portë Pozitiv     | 6           | 4            |
| Gjuajtjet në portë Negativ     | 13          | 13           |
| Auta – pozitiv                 | 19          | 13           |
| Auta – negativ                 | 0           | 1            |
| Korna                          | 4           | 6            |
| Faulla                         | 8           | 12           |
| Sulmet e ekipit                | 71          | 59           |



| Ekipe                          | Gjermania 0 | SHBA 0 |
|--------------------------------|-------------|--------|
| Përqindja e posedimit të topit | 67          | 33     |
| Pasimet e gjata Pozitiv        | 71          | 49     |
| Pasimet e gjata Negativ        | 8           | 13     |
| Pasimet e shkurtra Pozitiv     | 152         | 132    |
| Pasimet e shkurtra Negativ     | 7           | 14     |
| Gjuajtjet në portë Pozitiv     | 6           | 0      |
| Gjuajtjet në portë Negativ     | 13          | 4      |
| Auta – pozitiv                 | 17          | 12     |
| Auta – negativ                 | 0           | 0      |
| Korna                          | 3           | 2      |
| Faulla                         | 9           | 15     |
| Sulmet e ekipit                | 71          | 59     |

| Ekipe                          | Gjermania 2 | Algjeria 1 |
|--------------------------------|-------------|------------|
| Përqindja e posedimit të topit | 67          | 33         |
| Pasimet e gjata Pozitiv        | 64          | 40         |
| Pasimet e gjata Negativ        | 5           | 9          |
| Pasimet e shkurtra Pozitiv     | 161         | 130        |
| Pasimet e shkurtra Negativ     | 2           | 9          |
| Gjuajtjet në portë Pozitiv     | 14          | 4          |
| Gjuajtjet në portë Negativ     | 28          | 10         |
| Auta – pozitiv                 | 21          | 13         |
| Auta – negativ                 | 0           | 1          |
| Korna                          | 10          | 4          |
| Faulla                         | 11          | 20         |
| Sulmet e ekipit                | 68          | 57         |

| Ekipet                         | Gjermania 1 | Franca 0 |
|--------------------------------|-------------|----------|
| Përqindja e posedimit të topit | 51          | 49       |
| Pasimet e gjata Pozitiv        | 73          | 62       |
| Pasimet e gjata Negativ        | 5           | 4        |
| Pasimet e shkurtra Pozitiv     | 158         | 147      |
| Pasimet e shkurtra Negativ     | 2           | 11       |
| Gjuajtjet në portë Pozitiv     | 3           | 5        |
| Gjuajtjet në portë Negativ     | 9           | 13       |
| Auta – pozitiv                 | 18          | 15       |
| Auta – negativ                 | 1           | 0        |
| Korna                          | <b>3</b>    | <b>5</b> |
| Faulla                         | 18          | 15       |
| Sulmet e ekipit                | 71          | 68       |

| Ekipet                         | Gjermania 7 | Brazili 1 |
|--------------------------------|-------------|-----------|
| Përqindja e posedimit të topit | 53          | 47        |
| Pasimet e gjata Pozitiv        | 76          | 63        |
| Pasimet e gjata Negativ        | 7           | 13        |
| Pasimet e shkurtra Pozitiv     | 168         | 157       |
| Pasimet e shkurtra Negativ     | 4           | 9         |
| Gjuajtjet në portë Pozitiv     | 8           | 10        |
| Gjuajtjet në portë Negativ     | 14          | 18        |
| Auta – pozitiv                 | 15          | 11        |
| Auta – negativ                 | 0           | 0         |
| Korna                          | <b>5</b>    | <b>7</b>  |
| Faulla                         | 14          | 11        |
| Sulmet e ekipit                | 71          | 64        |

## Finale

| Ekipet                         | Gjermania 1 | Argjentina 0 |
|--------------------------------|-------------|--------------|
| Përçindja e posedimit të topit | 64          | 36           |
| Pasimet e gjata Pozitiv        | 62          | 60           |
| Pasimet e gjata Negativ        | 7           | 8            |
| Pasimet e shkurtra Pozitiv     | 167         | 160          |
| Pasimet e shkurtra Negativ     | 4           | 2            |
| Gjuajtjet në portë Pozitiv     | 5           | 0            |
| Gjuajtjet në portë Negativ     | 10          | 10           |
| Auta – pozitiv                 | 17          | 13           |
| Auta – negativ                 | 0           | 0            |
| Korna                          | 5           | 3            |
| Faulla                         | 20          | 16           |
| Sulmet e ekipit                | 69          | 66           |

### 4.3. METODAT E PËRPUNIMIT TË REZULTATEVE

Në bazë të qëllimit dhe hipotezave të parashtruara, janë aplikuar metodat e përpunimit të rezultateve të cilat mundësojnë sigurimin e informatave të mjaftueshme për realizimin e qëllimit.

Për gjitha grupet e sistemit të variablove janë llogaritur parametrat themelorë statistikorë dhe të shpërndarjes për secilën variabël, si dhe masat e asimetrisë dhe të shpërndarjes normale.

- **Vlerat minimale dhe maksimale ( R.min-R.maks)**
- **Mesatarja aritmetikore (Ma)**
- **Devijimi standard(Ds)**
- **Parametrat e asimetrisë (SKEW dhe KURT)**

**Raportet e ndërlidhjeve** ndërmjet variablove në hapësirën manifeste, si dhe korrelacionet ndërmjet sistemit të variablove.

**Për vërtetimin e ndryshimeve** ndërmjet ekipeve fituese dhe ekipeve humbëse në parametrat e teknikës së lojës është aplikuar analiza univariante e variancës ANOVA.

Për përcaktimin e ndikimit të ndryshoreve prediktore (testeve situacionale - teknike) dhe ndryshores kritere (sulmet e ekipit) është aplikuar **analiza regresive** në hapësirën manifeste.

## 5. INTERPRETIMI I REZULTATEVE DHE DISKUTIMI

### 5.1. TREGUESIT THEMELOR STATISTIKOR

#### *5.1.1 Parametrat themelor statistikor dhe të shpërndarjes të elementeve tekniko-taktike te ekipi i Argjentinës*

Ekipi i Argjentinës ishte ekipi i cili humbi në ndeshjen finale në Kampionatin Botëror, Brazili 2014. Në tabelën 1 janë të paraqitur parametrat themelor statistikor dhe të shpërndarjes sipas analizës deskriptive të 7 ndeshjeve në Kampionatin Botëror, Brazili 2014 të cilat i ka zhvillua ekipi humbës në finale, ekipi i Argjentinës. Janë përfshirë 7 ndeshje, ku janë të paraqitura vlerat e mesatares aritmetikore, rezultati minimal, rezultati maksimal, devijimi standard, parametrat e shpërndarjes ose të asimetrisë (Skewness – asim, asimetri) dhe shkalla e shtrirjes së kulmit të lakores të distribucionit të rezultateve (Kurtosis – konveksitet). Distribucioni normal i rezultateve të fituara nga vlerësimi i ndryshoreve antropometrike është testuar me anë të metodës së Kolmogorovit-Smirnovit (KS) dhe Shapiro-Wilkut (SHW).

Mesatarja aritmetikore e variablës tekniko-taktike, përqindja e posedimit të topit (PPOT) është 54.85 min. Rezultati minimal (36.00 min) dhe ai maksimal (74.00 min) i ndryshores tekniko-taktike, përqindja e posedimit të topit tregon se ekziston një dallim të theksuar në mes ndeshjeve në këtë ndryshore tekniko-taktike, si dhe një asim të lehtë të ndryshores ka rezultatet më të larta, sepse testi i asimetrisë është negativ (hipokurtik). Ekipi i Argjentinës në bazë të rezultateve të arritura në këtë ndryshore tekniko-taktike në 7 ndeshje, paraqitet si ekip mesatarisht homogjene me një numër më të madhe të ndeshjeve me vlera kah ato më të larta. Edhe pse ekziston dallim i theksuar në mes kohës minimale të posedimit të topit dhe kohës maksimale të posedimit të topit, shihet se lakueshmëria dhe konveksiteti i fituar (Skewness dhe Kurtosis) nuk tregojnë një asimetri të theksuar. Testi i Kolmogorovit-Smirnovit (KS) dhe Shapiro-Wilkut (SHW) tregon se rezultatet e ekipit të Argjentinës në 7 ndeshje në kohën e posedimit të topit nuk ka shmangie nga distribucioni normal.

Mesatarja aritmetikore e variablës tekniko-taktike, Pasimet e gjata pozitive të topit (PGJP) është 42.42 pasime. Rezultati minimal (34 pasime) dhe ai maksimal (74 pasime) i ndryshores tekniko-taktike, Pasimet e gjata pozitive të topit tregon se ekziston një dallim të theksuar në mes

ndeshjeve në këtë ndryshore tekniko-taktike, si dhe një anim të lehtë të ndryshores ka rezultatet më të ulëta, sepse testi i asimetrisë është pozitivë (epikurtik). Ekipi i Argjentinës në bazë të rezultateve të arritura në këtë ndryshore tekniko-taktike në 7 ndeshje, paraqitet si ekip, shumë heterogjen me një numër më të madhe të ndeshjeve me vlera kah ato më të ulëta. Fakti se ekziston dallim i theksuara në mes numrit minimal të pasimeve të gjata pozitive të topit në një ndeshje dhe numrit maksimal të pasimeve të gjata pozitive të topit në një ndeshje, shihet se lakueshmëria dhe konveksiteti i fituar (Skewness dhe Kurtosis) tregojnë një asimetri të theksuar. Testi i Kolmogorovit-Smirnovit (KS) dhe Shapiro-Wilkut (SHW) tregojnë se rezultatet e ekipit të Argjentinës në 7 ndeshje në numrin e pasimeve të gjata pozitive të topit nuk ka shmangie nga distribucioni normal.

Mesatarja aritmetikore e variablës tekniko-taktike, pasimet e gjata negative të topit (PGJN) është 12.85 pasime. Rezultati minimal (6 pasime) dhe ai maksimal (26 pasime) i ndryshores tekniko-taktike, pasimet e gjata negative të topit tregon se ekziston një dallim të theksuar në mes ndeshjeve në këtë ndryshore tekniko-taktike, si dhe një anim të lehtë të ndryshores ka rezultatet më të ulëta, sepse testi i asimetrisë është pozitivë (epikurtik). Ekipi i Argjentinës në bazë të rezultateve të arritura në këtë ndryshore tekniko-taktike në 7 ndeshje, paraqitet si ekip, shumë heterogjen me një numër më të madhe të ndeshjeve me vlera kah ato më të ulëta. Fakti se ekziston dallim i theksuara në mes numrit minimal të pasimeve të gjata negative të topit në një ndeshje dhe numrit maksimal të pasimeve të gjata negative të topit në një ndeshje, shihet se lakueshmëria dhe konveksiteti i fituar (Skewness dhe Kurtosis) tregojnë një asimetri të theksuar. Testi i Kolmogorovit-Smirnovit (KS) dhe Shapiro-Wilkut (SHW) tregojnë se rezultatet e ekipit të Argjentinës në 7 ndeshje në numrin e pasimeve të gjata negative të topit nuk ka shmangie nga distribucioni normal.

Mesatarja aritmetikore e variablës tekniko-taktike, pasimet e shkurtra pozitive të topit (PSHP) është 157.71 pasime. Rezultati minimal (148 pasime) dhe ai maksimal (170 pasime) i ndryshores tekniko-taktike, pasimet e shkurtra pozitive të topit tregojnë se ekziston një dallim i theksuar në mes ndeshjeve në këtë ndryshore tekniko-taktike, si dhe një anim të lehtë të ndryshores ka rezultatet më të ulëta, sepse testi i asimetrisë është pozitivë (epikurtik). Ekipi i Argjentinës në bazë të rezultateve të arritura në këtë ndryshore tekniko-taktike në 7 ndeshje, paraqitet si ekip, mesatarisht homogjen me një numër më të madhe të ndeshjeve me vlera kah

ato më të ulëta. Edhe pse ekziston dallim i theksuara në mes numrit minimal të pasimeve të shkurtra pozitive të topit në një ndeshje dhe numrit maksimal të pasimeve të shkurtra pozitive të topit në një ndeshje, shihet se lakueshmëria dhe konveksiteti i fituar (Skewness dhe Kurtosis) nuk tregojnë një asimetri të theksuar. Testi i Kolmogorovit-Smirnovit (KS) dhe Shapiro-Wilkut (SHW) tregojnë se rezultatet e ekipit të Argjentinës në 7 ndeshje në numrin e pasimeve të shkurtra pozitive të topit nuk ka shmangie nga distribucioni normal.

Mesatarja aritmetikore e variablës tekniko-taktike, pasimet e shkurtra negative të topit (PSHN) është 9.14 pasime. Rezultati minimal (2 pasime) dhe ai maksimal (12 pasime) i ndryshores tekniko-taktike, pasimet e shkurtra negative të topit tregojnë se ekziston një dallim i theksuar në mes ndeshjeve në këtë ndryshore tekniko-taktike, si dhe një anim të lehtë të ndryshores ka rezultatet më të larta, sepse testi i asimetrisë është negativ (hipokurtik). Ekipi i Argjentinës në bazë të rezultateve të arritura në këtë ndryshore tekniko-taktike në 7 ndeshje, paraqitet si ekip, shumë heterogjen me një numër më të madhe të ndeshjeve me vlera kah ato më të larta. Fakti se ekziston dallim i theksuara në mes numrit minimal të pasimeve të shkurtra negative të topit në një ndeshje dhe numrit maksimal të pasimeve të shkurtra negative të topit në një ndeshje, shihet se lakueshmëria dhe konveksiteti i fituar (Skewness dhe Kurtosis) tregojnë një asimetri të theksuar. Testi i Kolmogorovit-Smirnovit (KS) dhe Shapiro-Wilkut (SHW) tregojnë se rezultatet e ekipit të Argjentinës në 7 ndeshje në numrin e pasimeve të shkurtra negative të topit ka shmangie nga distribucioni normal.

Mesatarja aritmetikore e variablës tekniko-taktike, gjuajtjet pozitive në portë (GJPP) është 42.42 gjuajtje. Rezultati minimal (0 gjuajtje) dhe ai maksimal (13 gjuajtje) i ndryshores tekniko-taktike, gjuajtjet pozitive në portë tregojnë se ekziston një dallim i theksuar në mes ndeshjeve në këtë ndryshore tekniko-taktike, si dhe një anim të lehtë të ndryshores ka rezultatet më të ulëta, sepse testi i asimetrisë është pozitiv (epikurtik). Ekipi i Argjentinës në bazë të rezultateve të arritura në këtë ndryshore tekniko-taktike në 7 ndeshje, paraqitet si ekip, shumë heterogjen me një numër më të madhe të ndeshjeve me vlera kah ato më të ulëta. Fakti se ekziston dallim i theksuara në mes numrit minimal të gjuajtjeve pozitive në portë në një ndeshje dhe numrit maksimal të gjuajtjeve pozitive në portë të topit në një ndeshje, shihet se lakueshmëria dhe konveksiteti i fituar (Skewness dhe Kurtosis) tregojnë një asimetri të theksuar. Testi i Kolmogorovit-Smirnovit (KS) dhe Shapiro-Wilkut (SHW) tregon se rezultatet e ekipit të

Argjentinës në 7 ndeshje në numrin e Gjuajtjeve pozitive në portë nuk ka shmangie nga distribucioni normal.

Mesatarja aritmetikore e variablës tekniko-taktike, gjuajtja negative në portë (GJNP) është 15.42 gjuajtje. Rezultati minimal (8 gjuajtje) dhe ai maksimal (29 gjuajtje) i ndryshores tekniko-taktike, gjuajtjet negative në portë tregojnë se ekziston një dallim i theksuar në mes ndeshjeve në këtë ndryshore tekniko-taktike, si dhe një anim të lehtë të ndryshores ka rezultatet më të ulëta, sepse testi i asimetrisë është pozitiv (epikurtik). Ekipi i Argjentinës në bazë të rezultateve të arritura në këtë ndryshore tekniko-taktike në 7 ndeshje, paraqitet si ekip, shumë heterogjen me një numër më të madhe të ndeshjeve me vlera kah ato më të ulëta. Fakti se ekziston dallim i theksuara në mes numrit minimal të gjuajtjeve negative në portë në një ndeshje dhe numrit maksimal të gjuajtjeve negative në portë të topit në një ndeshje, shihet se lakueshmëria dhe konveksiteti i fituar (Skewness dhe Kurtosis) tregojnë një asimetri të theksuar. Testi i Kolmogorovit-Smirnovit (KS) dhe Shapiro-Wilkut (SHW) tregojnë se rezultatet e Ekipit të Argjentinës në 7 ndeshje në numrin e gjuajtjeve negative në portë nuk ka shmangie nga distribucioni normal.

Mesatarja aritmetikore e variablës tekniko-taktike, auta pozitiv (AUTP) është 19.85 rivënie. Rezultati minimal (13 rivënie) dhe ai maksimal (23 rivënie) i ndryshores tekniko-taktike, Auta pozitiv tregon se ekziston një dallim i theksuar në mes ndeshjeve në këtë ndryshore tekniko-taktike, si dhe një anim të lehtë të ndryshores ka rezultatet më të larta, sepse testi i asimetrisë është negativ (hipokurtik). Ekipi i Argjentinës në bazë të rezultateve të arritura në këtë ndryshore tekniko-taktike në 7 ndeshje, paraqitet si ekip, shumë heterogjen me një numër më të madhe të ndeshjeve me vlera kah ato më të larta. Fakti se ekziston dallim i theksuara në mes numrit minimal të autave pozitiv në një ndeshje dhe numrit maksimal të autave pozitiv në një ndeshje, shihet se lakueshmëria dhe konveksiteti i fituar (Skewness dhe Kurtosis) tregojnë një asimetri të theksuar. Testi i Kolmogorovit-Smirnovit (KS) dhe Shapiro-Wilkut (SHW) tregon se rezultatet e ekipit të Argjentinës në 7 ndeshje në numrin e autave pozitiv nuk ka shmangie nga distribucioni normal.

Mesatarja aritmetikore e variablës tekniko-taktike, auta negativ (AUTN) është 0.42 rivënie. Rezultati minimal (0 rivënie) dhe ai maksimal (1 rivënie) i ndryshores tekniko-taktike, auta negativ tregon se ekziston një dallim të theksuar në mes ndeshjeve në këtë ndryshore



tekniko-taktike, si dhe një anim të lehtë të ndryshores ka rezultatet më të ulëta, sepse testi i asimetrisë është pozitiv (epikurtik). Ekipi i Argjentinës në bazë të rezultateve të arritura në këtë ndryshore tekniko-taktike në 7 ndeshje, paraqitet si ekip, mesatarisht homogjen me një numër më të madhe të ndeshjeve me vlera kah ato më të ulëta. Edhe pse ekziston dallim i theksuara në mes numrit minimal të autave negativ në një ndeshje dhe numrit maksimal të autave negativ në një ndeshje, shihet se lakueshmëria dhe konveksiteti i fituar (Skewness dhe Kurtosis) nuk tregojnë një asimetri të theksuar. Testi i Kolmogorovit-Smirnovit (KS) dhe Shapiro-Wilkut (SHW) tregon se rezultatet e ekipit të Argjentinës në 7 ndeshje në numrin e autave negativ ka shmangie nga distribucioni normal.

Mesatarja aritmetikore e variablës tekniko-taktike, korna (KORN) është 6.85 rivënie. Rezultati minimal (2 rivënie) dhe ai maksimal (13 rivënie) i ndryshores tekniko-taktike, korna tregon se ekziston një dallim të theksuar në mes ndeshjeve në këtë ndryshore tekniko-taktike, si dhe një anim të lehtë të ndryshores ka rezultatet më të ulëta, sepse testi i asimetrisë është pozitiv (epikurtik). Ekipi i Argjentinës në bazë të rezultateve të arritura në këtë ndryshore tekniko-taktike në 7 ndeshje, paraqitet si ekip, mesatarisht homogjen me një numër më të madhe të ndeshjeve me vlera kah ato më të ulëta. Edhe pse ekziston dallim i theksuara në mes numrit minimal të kornave në një ndeshje dhe numrit maksimal të kornave në një ndeshje, shihet se lakueshmëria dhe konveksiteti i fituar (Skewness dhe Kurtosis) nuk tregojnë një asimetri të theksuar. Testi i Kolmogorovit-Smirnovit (KS) dhe Shapiro-Wilkut (SHW) tregon se rezultatet e ekipit të Argjentinës në 7 ndeshje në numrin e kornave nuk ka shmangie nga distribucioni normal.

